

LIGJ
Nr.8373, datë 15.7.1998

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 19.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 28 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 " Për dispozitat kryesore kushtetuese ""', me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Neni 2

Gjykata Kushtetuese është e pavarur nga çdo organ tjetër në ushtrimin e funksioneve, në organizimin e saj, si dhe në marrëdhëniet financiare.

Është i ndaluar çdo veprim që cenon pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e funksioneve të saj, në marrëdhëniet financiare, si dhe në ato në lidhje me informacionin e kuadrin.

Neni 3

Vendi i ndodhjes së Gjykatës Kushtetuese është kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, Tirana.

Neni 4

Gjykata Kushtetuese harton buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, duhet t'i paraqitet Kuvendit Popullor për miratim.

**II. PËRBËRJA E GJYKATËS KUSHTETUESE
DHE STATUSI I ANËTARËVE TË SAJ**

Neni 5

Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese caktohen juristë, shtetas shqiptarë të njohur për aftësitë e tyre profesionale, që kanë punuar jo më pak se 10 vjet ne veprimtarinë juridike ose si pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë dhe që kanë reputacion të lartë moral.

Neni 6

Gjyqtari kushtetues fillon nga funksioni i tij pasi bën betimin para Presidentit të Republikës, sipas formulës të parashikuar në nenin 19 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Mandati i tij fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Kur vendi i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese mbetet vakant, anëtari i ri duhet të caktohet brenda një muaji.

Neni 7

Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që gjyqtari, kundër të cilit ka filluar ndjekja penale, të mos ushtrojë detyrat në Gjykatën Kushtetuese deri në dhënien e vendimit të formës së prerë. Gjatë kësaj kohe, gjyqtari gëzon të drejtën e shpërblimit.

Neni 8

Funksioni i gjyqtarit kushtetues mbaron kur:

- a) nuk e ushtron pa shkaqe të përligjura detyrën për më shumë se 6 muaj;
- b) jep dorëheqjen;
- c) kur caktohet në detyra që nuk pajtohen me funksionin e tij;
- ç) kalon afati për të cilin është zgjedhur;
- d) kur mungojnë kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Mbarimi i mandatit për rastet e parashikuara në pikat "a-ç" shpallet nga kryetari, kurse për rastin e parashikuar nga pika "d", vendimi merret nga mbledhja e përgjithshme, kur për atë kanë votuar 2/3 e anëtarëve.

Neni 9

Paga e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.

Paga e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e anëtarëve.

III. ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 10

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga anëtarët, me votim të fshehtë kur për atë kanë votuar shumica absolute e anëtarëve. Nëse gjatë raundit të parë, asnjë nga kandidaturat nuk fiton shumicën absolute të anëtarëve ose nëse kandidatë të ndryshëm fitojnë një numër të barabartë votash, atëherë përsëritet procesi i votimit. Në përfundim të raundit të dytë quhet se ka fituar ai që ka numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta edhe në këtë raund, quhet i fituar më i moshuari prej tyre.

Neni 11

Në mungesë të kryetarit, njëri nga anëtarët e caktuar prej tij kryen detyrat e caktuara prej tij.

Neni 12

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emëron sekretarin e përgjithshëm, i cili drejton punën e administratës gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj.

Sekretari i përgjithshëm duhet të jetë jurist me përvojë profesionale.

Neni 13

Me iniciativën e jo më pak se tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët paraqesin të dhëna të mjaftueshme se kryetari ka kryer shkelje të rënda në detyrë, ky i fundit mund të lirohet nga detyra.

Lirimi bëhet i mundur nëse për të kanë votuar jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 14

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

- a) përfaqëson Gjykatën më të tretet;
- b) drejton seancat gjyqësore;
- c) administron buxhetin;
- ç) organizon punën midis gjyqtarëve;
- d) vendos për strukturat administrative, merr në punë, largon nga puna dhe merr masa disiplinore ndaj personelit të Gjykatës Kushtetuese;
- dh) nënshkruan aktet e Gjykatës (me përjashtim të vendimeve gjyqësore që nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët);
- e) vendos për numrin e personelit e pagat e tyre brenda fondeve financiare të miratuara.

IV. RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 15

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të pavarur dhe udhëhiqen në kryerjen e detyrave të tyre vetëm nga Kushtetuta dhe nga ky ligj.

Në veprimtarinë e tyre, gjyqtarët marrin pjesë me cilësinë e tyre vetjake dhe nuk përfaqësojnë asnjë organ shtetëror e organizatë shoqërore, parti e shoqatë politike, grupe etnike apo sociale.

Vendimet dhe aktet e Gjykatës Kushtetuese shprehin bindjet juridike të gjyqtarëve.

Neni 16

Shqyrtimi i çështjeve bëhet kolegjisht. Vendimi rnerret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Neni 17

Shqyrtimi i çështjeve në seancë nga Gjykata Kushtetuese bëhet i hapur. Gjykata vendos shqyrtimin me dyer të mbyllura në raste të veçanta, kur ajo e çmon të nevojshme.

Neni 18

Shqyrtimi i çështjes në seancat e Gjykatës Kushtetuese është gojor. Në rastet e administrimit të dokumenteve shkresore, ato lexohen në seancë gjyqësore.

Neni 19

Në shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata përdoret gjuha shqipe.

Në rastet kur pjesëmarrësit në proces nuk dinë gjuhën shqipe apo kur dokumentet që administrohen janë në gjuhë të huaj, Gjykata cakton një përkthyes.

Neni 20

Shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese fillon jo më vonë se dy muaj nga paraqitja e kërkesës.

Neni 21

Gjykata Kushtetuese i shqyrton çështjet në seancë plenare, e cila thirret nga kryetari.

Në seancë plenare duhet të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 22

Në seancën plenare marrin pjesë kërkuessit, përfaqësuesit e tyre, ekspertët, dëshmitarët, përkathtësit dhe subjektet e interesuara.

Neni 23

Pjesëmarrës në procesin gjyqësor kushtetues janë:

- a) subjektet që kanë paraqitur kërkesë;
- b) personat apo organet, kundër të cilëve është paraqitur kërkesa;
- c) organet apo personat zyrtarë që kanë lëshuar aktin, kushtetueshmëria ose ligjshmëria të cilit do të shqyrtohet;
- ç) organet shtetërore që janë në konflikt për kompetencat e tyre.

Në rastet kur pjesëmarrës janë organet shtetërore, në Gjykatën Kushtetuese ato përfaqësohen nga drejtuesit e tyre dhe, në mungesë të tyre, nga persona zyrtarë të autorizuar me shkrim.

Përfaqësues të palëve mund të jenë edhe avokatët. Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton avokatët që mund të marrin pjesë në procesin gjyqësor kushtetues.

Neni 24

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk merr pjesë në shqyrtimin e një çështje kur:

- a) gjyqtari para se të merrte detyrën, ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;
- b) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me palët në proces vihet në dyshim objektiviteti i gjyqtarit.

Mospjesëmarrja e gjyqtarit vendoset kur për të kanë votuar shumica absolute e anëtarëve pjesëmarrës në proces.

Neni 25

Seanca plenare hapet nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari verifikon prezencën e pjesëmarrësve në proces, iu shpjegon atyre të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë.

Pasi lexohet kërkesa, si dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj, ftohen palët, si dhe përfaqësuesit e tyre të bëjnë shpjegimet e nevojshme.

Neni 26

Në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe sekretarja.

Neni 27

Në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese, me kërkesën e palëve ose kryesisht mund të thirren me cilësinë e ekspertit persona të cilët kanë njohuri për problemet që lidhen me çështjen në shqyrtim.

Neni 28

Për të drejtat, detyrimet e përgjegjësitë e pjesëmarrësve në proces, dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe për vlerësimin e përfundimeve të saj, Gjykata bazohet në rregullat e përgjithshme procedurale.

Neni 29

Kur shihet i domosdoshme sqarimi i rrethanave faktike, që lidhen me çështjen në shqyrtim, me kërkesën e palëve ose kryesisht, Gjykata mund të therrasë persona me cilësinë e dëshmitarit.

Neni 30

Në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese, me kërkesën e pjesëmarrësve ose kryesisht mund të administrohen dokumente, të cilat me vendim të Gjykatës bashkohen me materialet e tjera të çështjes.

Neni 31

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesat përfundimtare. Gjykata Kushtetuese me kërkesën e palëve mund të caktojë një afat për përgatitjen e palëve për të bërë kërkesat përfundimtare.

Në kërkesat përfundimtare, pjesëmarrësit nuk lejohen që t'i bazojnë ato në dokumente e prova të tjera që nuk janë administruar gjatë seancës gjyqësore.

Neni 32

Nëse pas parashtrimit nga palët të kërkesave përfundimtare, Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme sqarimin e rrethanave plotësuese, të cilat kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendos riçeljen e shqyrtimit gjyqësor.

Neni 33

Kur Gjykata Kushtetuese vlerëson se zbatimi i ligjit apo aktit që kundërshtohet mund të sjellë pasoja që prekin interesat shtetërore, shoqërore ose të personave, merr vendim të veçantë për pezullim, i cili vazhdon derisa vendimi përfundimtar të hyjë në fuqi. Megjithatë, Gjykata, në çdo fazë të gjykimit, me vendim të veçantë mund të heqë masën e pezullimit.

V. KËRKESAT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Neni 34

Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj.

Për fillimin e procedurës kanë të drejtë të bëjnë kërkesë:

a) Presidenti i Republikës për çështjet e parashikuara nga neni 24, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992.

b) Grupi parlamentar ose 1/5 e deputetëve për çështjet e parashikuara nga neni 24, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 të ligjit të mësipërm.

c) Këshilli i Ministrave për çështjet e parashikuara nga neni 24, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9 të ligjit të mësipërm.

ç) Organet lokale të pushtetit për çështjet e parashikuara nga neni 24, pikat 1, 2, 3, 5, 7 të ligjit të mësipërm.

d) Gjykatat e çdo shkalle për çështjet e parashikuara nga neni 24, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 të ligjit të mësipërm.

dh) Çdo person fizik apo juridik për çështjet e parashikuara nga neni 24, pika 9 e ligjit të mësipërm.

Kërkesat për shqyrtimin e akuzës penale të ngritura kundër Presidentit të Republikës, bëhen nga Kuvendi Popullor konform nenit 31 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Procedurat që ndiqen me këtë rast rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 35

Kërkesat para Gjykatës Kushtetuese nuk kanë afat, me përjashtim të kërkesës për shkelje të

lirive e të drejtave themelore të individit, të cilat duhet të bëhen jo më vonë se gjashtë muaj nga konstatimi i shkeljes.

Neni 36

Kur për shkeljen e lirive dhe të drejtave kushtetuese, personi ligjërisht mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të ushtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, si rregull, vetëm pasi të ketë përdorur të gjitha mjetet e tjera juridike për mbrojtjen e së drejtës së tij. Në këtë rast, afati për paraqitjen e kërkesës është gjashtë muaj nga data e vendimit të organit përkatës shtetëror.

Neni 37

Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje me nismën e saj për çështje të rëndësishme dhe kur për këtë janë dakord shumica absolute e anëtarëve të saj.

Kur gjatë shqyrtimit të një çështje, filluar mbi bazën e një kërkesë, zbulohen rrethana që kanë të bëjnë me çështje të tjera, të parashikuara nga neni 24 i ligjit "Për disa ndrvshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", nr.7561, datë 29.4.1992, Gjykata Kushtetuese kryesisht merr vendim për fillimin e çështjes dhe bashkimin me çështjen në proces.

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes si rregull janë brenda objektit të kërkesës. Përgjashtim vendoset për çdo rast konkret nga Gjykata.

Neni 38

Kërkesat për verifikim paraprak i paraqiten kryetarit, i cili cakton një ose disa relatorë. Relatorët ia parashitjnë kërkesën trupit gjykues prej tre anëtarësh. Në rast kur kërkesa çmohet se është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është bërë prej subjekteve të parashikuara nga ligji kushtetues, por nuk plotëson kërkesat formale të parashikuara nga ligji, trupi gjykues i kërkon subjektit plotësimin e kërkesave brenda një afati të arsyeshëm.

Kur ata nuk vendosin me konsensus, atëherë çështja kalon përsëri për shqyrtim paraprak në seancë plenare.

Kur trupi gjykues prej tre vetësh ose mbledhja e përgjithshme arrin në përfundimin se në kërkesë ekziston shkak dhe baza për shqyrtim gjyqësor, çështja kalohet për gjykim, duke njoftuar palët dhe subjektet e interesuara. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme është i vlefshëm kur për të kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm.

Neni 39

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese përjashtohen nga pagimi i shpenzimeve dhe taksat.

Për shërbimet që përballohen nga Gjykata Kushtetuese, mund të vendosen tarifa me ligj të veçantë.

Neni 40

Çdo organ shtetëror, person juridik ose fizik detyrohet t'i japë Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna ose njoftime kur ato kërkohen e janë të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.

VI. VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE

Neni 41

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve. Abstenimi nuk lejohet.

Bisedimet, si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë. Ndalohet përhapja e përmbajtjes së bisedimeve shqyrtimin e çështjes.

Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.

Gjyqtari në pakicë ka të drejtë t'i bashkëlidhë vendimit mendimin e tij të veçantë të formuluar me shkrim.

Kur një ose disa anëtarë, që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, mungojnë gjatë bisedimit e votimit ose pas bisedimit e para votimit, Gjykata merr vendim, mjafton që të formohet shumica e anëtarëve. Kur shumica nuk formohet, bisedimet e votimet shtyhen deri në një muaj. Pas këtij afati, riçelet seanca gjyqësore nga fillimi.

Neni 42

Kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë nga grupet e anëtarëve nuk përbën shumicën e kërkuar, Gjykata vendos refuzimin e kërkesës.

Neni 43

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që bëjnë interpretimin e Kushtetutës kanë fuqi prapavepruese.

Neni 44

Kur Gjykata Kushtetuese vë re se është shkelur një e drejtë e mbrojtur nga ligji kushtetues, ajo vendos njohjen dhe garantimin e saj, dhe kur është rasti, ndreqjen e pasojave dhe kompensimin e duhur të dëmit të shkaktuar, duke zbatuar me këtë rast dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 45

Vendimet e gjykatave të çdo hallke, të cilat shpallen nga Gjykata Kushtetuese si antikushtetuese për shkak të shfuqizimit të aktit normativ në të cilin janë bazuar ose për shkak se janë cenuar të drejtat kushtetuese të personave, nuk sjellin efekte juridike.

Neni 46

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.

Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit.

Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo pengojnë zbatimin, kur veprimi i tyre nuk përbën vepër penale, denohen me gjobë deri në 100 mijë lekë. Këto vendime përbëjnë titull ekzekutiv.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 47

Për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese përgatitet rregullorja e brendshme që miratohet nga kryetari i saj.

Neni 48

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2164, datë 23.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani